



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



## FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

### Shtojca 14

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

04.12.2019

Për: **“Alstezo” sh.a., Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rruga “Butrinti”, Kashar, Tiranë**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“Mirëmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit” “Kërkesë për Propozim”**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-32155-07-31-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Mirëmbajtje, riparim dhe vendosje e pjesëve të këmbimit për automjetet e Fondit deri më 31.12.2019**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike Datë 22 Korrik 2019 Nr. 29**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "Power Industries" sh.p.k. L51706022H

Vlera: 2,268,000 (dy million e dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë pa TVSH

2. Operatori ekonomik "Servis Auto 2000" sh.p.k. K31523078F

Vlera: 2,486,990 lekë (dy million e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik "Alstezo" sh.a. J63208420N

Vlera: 2,691,000 (dy million gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik "Kadiu" sh.p.k.

J61817045K

Vlera: 2,706,800 (dy million e shtatëqind e gjashtë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "POWER INDUSTRIES" sh.p.k.

L51706022H

2. Operatori ekonomik "SERVIS AUTO 2000" sh.p.k.

K31523078F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

**1- Operatori ekonomik "POWER INDUSTRIES" sh.p.k.:**

- Nuk është cilësuar numri i urave ngritëse, sipas pikes 2.3, kapaciteti teknik, pika 4, gërma "c", të parashikuar në kriteret e veçanta për kualifikim;
- Nuk është cilësuar paraqitja e një aparati saldimi, sipas sipas pikes 2.3, kapaciteti teknik, pika 4, gërma "e", të parashikuar në kriteret e veçanta për kualifikim.

**2- Operatori ekonomik "SERVIS AUTO 2000" sh.p.k.:**

- Mungon Deklarata e Konfliktit të Interesit, sipas shtojcës 6, siç është parashikuar në Shtojcën 7, Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 1, gërma "d".

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, "*Alstezo*" sh.a., *Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Rruga "Butrinti", Kashar, Tiranë* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **2,691,000 (dy million gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë pa TVSH** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH), Rruga "Sami Frashëri", Nr. 8, Tiranë, Tel/Fax 00355 42232815, e-mail [info@fsdksh.gov.al](mailto:info@fsdksh.gov.al), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të ndiqen parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 58 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.11.2019

Ankesa:

1. Në datë 13.09.2019, është protokolluar pranë Autoritetit Kontraktor ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k., i cili kundërshton skualifikimin e kryer nga KVO duke pretenduar se ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim konform kërkesave të autoritetit dhe se skualifikimi i ofertës është bërë në mënyrë arbitrare dhe jo të bazuar;  
Ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktor.
2. Në datë 16.09.2019 është protokolluar pranë Autoritetit Kontraktor ankesa “Alstezo” sh.a. ku kërkohet riklasifikimi i ofertave duke klasifikuar ofertën ekonomike të paraqitur si dhe duke skualifikuar shoqërinë e kualifikuar pa të drejtë në kuadër të parimeve të barazisë, transparencës, etj.  
Ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik nuk është marrë parasysh nga Autoriteti Kontraktor.

Në datën 08.11.2019 jemi vënë në dijeni me shkresën Nr. 698/1 Prot., datë 06.11.2019 për vendimin me Nr.698/2019 të Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me pranimin e ankesës së paraqitur pranë saj nga operatori ekonomik “Alstezo” sh.a., duke vendosur kualifikimin e këtij të fundit si pushimin e procedimit administrativ në lidhje me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Power Industries” sh.p.k., për arsye të heqjes dorë në lidhje me pretendimet e parashtruara në Formularin e Ankesës drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.